



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



**Datë: 24.05.2024**

Mbledhja e Komisionit të Komunës për Vlerësimin e ofrimit të mbështetjes financiare publike për financimin e OJQ - ve, që kontribuojnë në: Promovimin e Barazië Gjinore dhe fuqizimin e rolit të grave në shoqëri.

## R A P O R T

Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e OJQ - ve, që kontribuojnë në: Promovimin e Barazië Gjinore dhe fuqizimin e rolit të grave në shoqëri. Kjo mbështetje është në kuadër të objektivave të parapara në 'Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2023 - 2025', në thirrjen publike është propozuar të mbështeten organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën si vijon:

- 1.1 Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.
- 1.2 Avancimi i barazisë gjinore përmes zhdukjes së pabarazive dhe stereotipeve gjinore.
- 1.3 Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje dhe qasja në drejtësi dhe
- 1.4 Parandalimin dhe Vetëdijësimin kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Kjo thirrje publike është realizuar duke respektuar, standardet më të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendimmarrjes në përputhje me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ - ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Drejtoria e Administratës, ka pranuar aplikimet e gjithsej shtatë (7) Organizata Jo Qeveritare, të cilat kanë paraqitur projektet e tyre për mbështetje financiare.

Lista e të gjitha OJQ - ve që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike:

1. Instituti Akademik Infinit Kosova - Fuqia e Diversitetit.
2. Ëomens Association AUREOLA - Rritja e pjesëmarrjes së grave në Vendimmarrje.
3. Nënë Madhja - Vetëdijësimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
4. Multiethnic Culture of Kosovo - Parandalimi i dhunës tek gratë në familjet Rome, Ashkali dhe Egjiptian.
5. FLORI - Fuqizimi i grave për një të ardhme më të mirë.
6. Ruka - Ruci - gratë për një jetë pa dhunë - drejtë një bashkëpunimi më efektiv në komunitetin lokal kundër dhunës ndaj grave.
7. Qendra për përkrahje dhe zhvillim të komuniteteve - Ngritja e vetëdijes dhe fuqizimi i grave dhe vazhata të komuniteteve pakicë kundër dhunës në baza gjinore.

Vlerësimi:

Drejtoria Administratës ka themeluar Komisionin Vlerësues me Nr. të vendimit 929/2024 i përbërë nga tre zyrtarë të Administratës dhe dy anëtarë/e tjera një nga Shoqëria Civile, një ekspert i jashtëm. Komisioni kishte për detyrë t'i vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.

Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes dhe sipas Rregullores së MF - Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas kriterëve të thirrjes publike dhe Rregullores MF - Nr. 04/2017, komisioni ka vlerësuar se vetëm pesë (5) aplikacione i plotësojnë kriteret sipas thirrjes.

Komisioni pas vlerësimit nxjerr listën përfundimtare.

Nr	Emri i OJQ-së	Titulli i projektit	Buxheti
1.	Instituti Akademi Infinit Kosova	Fuqia e Diversitetit	900€
2.	Ëomens Association AUREOLA	Rritja e pjesëmarrjes së grave në Vendimmarrje	1100€
3.	FLORI	Fuqizimi i grave për një të ardhme më të mirë.	1200€
4.	Qendra për përkrahje dhe zhvillim të komuniteteve	Ngritja e vetëdijes dhe fuqizimi i grave dhe vajzave të komuniteteve pakicë kundër dhunës në baza gjinore	700€
5.	Ruka - Ruci	Gratë për një jetë pa dhunë - drejtë një bashkëpubimi më efektiv në komunitetin lokal kundër dhunës ndaj grave.	1100€

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa për subvencione në Komunë në afatin prej pesë (5) ditëve nga data e publikimit. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje fizike në Drejtorinë e Administratës kati i dytë (2).

#### Anëtarët e Komisionit

Hasan Gjyrevci - Kryetar i Komisionit

Sladjana Lazic - Anëtare e Komisionit

Valdete Koca - Anëtare e Komisionit

Shemsije Fatahu - Anëtare e Komisionit

Hajrije Berisha - Anëtare e Komisionit

